



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____/____/202__

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË
KËSHILLIT BASHKIAK NR. 37 DATË 09.05.2022, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR.3, PALLATI NR. 32 RRUGA "HYSEN KËRTUSHA", I
DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË
DATËS 26 NËNTOR 2019".**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104 datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 14518 prot. datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimi i një shtese në Aneksin I bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 09.05.2022, përta i përket listës së përfituesve për Pallatin Nr.32 Rruga "Hysen Kërtusha", në Njësinë Administrative nr.3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE
36	JULIAN ÇELA	2	1+1


2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE


Drejtor

Aneida Broshi



KRYETAR

Emiriana Sako



KOMISIONI I POSAÇËM

Kryetar

Gentian Kallmi





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KOMISIONI I POSAÇËM**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË
KËSHILLIT BASHKIAK NR. 37 DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË
PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR.3 PALLATIN NR.32 RRUGA “HYSEN KËRTUSHA, I
DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR
2019.**

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimintë Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar. Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçmetë Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104 datë 08.07.2022, Raportit me nr. 14518 prot. datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.32

Rruga "Hysen Kërtusha, në Njësinë Administrative Nr.3, i dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, sipas relacionit si më poshtë vijon:

Të nderuar këshilltarë

Me Vendimin nr. 37 datë 09.05.2022, Këshilli Bashkiak ndër të tjera ka miratuar edhe listën e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.32 Rruga "Hysen Kërtusha", në Njësinë Administrative nr.3, i dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Duke qënë se ASHK vijon me kthimin e përgjigjeve lidhur me konfirmimin e pronësisë, si dhe plotësimin e dokumentacionit nga Njësia Administrative Nr.3, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve respektive Pallati nr.32, rruga "Hysen Kërtusha".

Ky dokumentacion dhe ky subjekt përfitues i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posacme e Rindërtimi, nëpërmjet :

1. Raportit nr. 13534 prot. datë 19.11.2024 për Pallatin Nr.32 Rruga "Hysen Kërtusha" ku kanë kualifikuar një subjekt që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime". Lidhur me një subjekt që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe e ka kualifikuar, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës 26 nëntor 2019.

Ky subjekt përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet :

1. Miratimi i një shtese në Aneksin 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 09.05.2022, për sa i përket listës së përfituesve për Pallatin Nr.32 Rruga "Hysen

Kërtusha", në Njësinë Administrative nr.3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
36	JULIAN ÇELA	2	1+1

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian	Kallmi	Kryetar	Robert Dervishi	Anëtar
Andri	Cerri	Anëtar	Diana Mandia	Anëtare
Klarita	Agasi	Anëtare	Lorenc Facja	Anëtar
Afroviti	Manthjo	Anëtare	Myslym Hasanaj	Anëtar